

TREMA TECH SH.P.K.
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

TREMA TECH SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar****Më 31 Dhjetor 2014**

AKTIVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	255,668	31,268
Llogari të arkëtueshme	5	12,546,577	16,907,705
Inventari	6	2,677,751	3,586,632
Aktive të tjera afatshkurtra	7	1,988,975	1,588,512
Total Aktiveve Afatshkurtra		17,468,971	22,114,117
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	840,572	1,053,790
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	100,000	100,000
Total aktive afatgjata		940,572	1,153,790
Total Aktive		18,409,543	23,267,907
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	10	10,299,642	10,940,456
Parapagimet e arkëtueshme	11	83,468	-
Llogari të pagueshme të tjera	12	5,682,973	8,852,450
Total Detyrime afatshkurtra		16,066,083	19,792,906
Detyrime afatgjata			
Detyrime të tjera afatgjata	13	8,526,212	8,534,785
Total Detyrime afatgjata		8,526,212	8,534,785
Totali i detyrimeve		24,592,295	28,327,691
Kapitali aksionar			
Kapitali	14	12,000,000	12,000,000
Rezerva të tjera		100,460	100,460
Rezerva ligjore		136,866	136,866
Fitime të mbartura		(17,297,110)	(11,154,178)
Fitimi i ushtrimit		(1,122,968)	(6,142,932)
Total kapitali		(6,182,752)	(5,059,784)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		18,409,543	23,267,907

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TREMA TECH SH.P.K.**Pasqyra Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Te ardhura	15	6,385,186	10,228,129
Te ardhura te tjera		-	247,130
Materiale te para dhe te konsumueshme	16	(4,989,891)	(8,207,639)
Shpenzime personeli	17	(1,815,911)	(6,849,780)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8	(213,218)	(259,330)
Shpenzime te tjera	18	(537,723)	(1,265,166)
Fitimi operativ		(1,171,557)	(6,106,656)
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	19	48,589	(36,275)
Total shpenzime financiare		48,589	(36,275)
Fitimi para tatimit	20	(1,122,968)	(6,142,931)
Fitimi i vitit		(1,122,968)	(6,142,932)
Te ardhura te tjera te pergjithshme		-	-
Totali i te ardhurave te pergjithshme		(1,122,968)	(6,142,932)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TREMA TECH SHPK
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	12,000,000	100,460	136,866	(11,154,178)	1,083,148
Fitimi i vitit				(6,142,932)	(6,142,932)
31 Dhjetor 2013	12,000,000	100,460	136,866	(17,297,110)	(5,059,784)
Fitimi i vitit				(1,122,968)	(1,122,968)
31 Dhjetor 2014	12,000,000	100,460	136,866	(18,420,078)	(6,182,752)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë Trema Tech sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 Mars 2015 nga:


Genc Sokolaj
Administrator
 Shënim "Karl Topia"
 Tiranë - Albania


Bernard Gushashi
Mazars Sh.p.k

TREMA TECH SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014

	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(1,122,968)	(6,142,931)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	213,218	259,330
Shpenzime për interesa	2,140	(164)
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	908,881	3,701,720
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	3,960,665	(1,008,346)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	(3,810,291)	4,090,992
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra	0	593,321
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra	83,468	
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	235,113	1,493,922
Interesa te paguara	(2,140)	164
	(2,140)	164
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	0	(65,749)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	0	(65,749)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huatë agjatgjata	(8,573)	(1,518,127)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	(8,573)	(1,518,127)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	224,400	(89,790)
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	31,268	121,058
Mjetet monetare ne fund te periudhës	255,668	31,268

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

“Trema Tech” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ne vitin 09.01.2008. ne perputhje me Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 “Per Shoqerite tregtare”.

Kapitali I Shoqerise eshte 12,000,000 Leke (dymbedhjetemilionleke), I ndare ne 100 kuota.

Trema Tech Sh.p.k eshte nje shoqeri shqiptare , e krijuar nga ortaket:

- Z.Illir Trebicka, qe zoteron 80% te kapitalit te shoqerise;
- Z.Genc Sokolaj qe zoteron 20% te kapitalit te shoqerise.

Aktiviteti kryesor i kesëj shoqërie është shitje, blerje, import-eksport te gjeneratoreve, kompresoreve dhe pjeseve te tyre te kembimit.

Administrator I shoqerise, duke filluar nga data 08.01.2008 eshte z. Genc Sokolaj

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga e duresit, sheshi Karl Topia, pll.127, kati 1, Tirane. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimpaguesve te Medhenj Tirane me Nipt K 81309063 C.

Numri I punonjesve te shoqerise me 31 dhjetor 2014 eshte 3.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%
Ndertesa	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mjete monetare në banke	167,866	23,300
Llogari rrjedhese	167,866	23,300
Mjete monetare në arke	87,802	7,968
	255,668	31,268

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente në All	1,220,341	668,181
Kliente në Euro	11,326,236	16,239,524
	12,546,577	16,907,705

6. INVENTARI

Gjendjet e Inventarit më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Lende e pare dhe materiale	325,339	358,896
Mallra për rishitje	2,352,412	3,227,736
Totali	2,677,751	3,586,632

TREMA TECH SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)***7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME**

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shteti – TVSH për tu rregulluar	400,364	-
Detyrime doganore	6,301	6,202
Tatim Fitimi	1,548,310	1,548,310
Te tjera	34,000	34,000
Totali	1,988,975	1,588,512

TREMA TECH SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)***8. AKTIVE AFATGJATA**

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje Orendi	Paisje Kompjuterike	Te Tjera	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	36,500	2,236,667	178,000	181,617	428,444	3,061,228
Shtesa					65,750	65,750
Nxjerrje jashtë përdorimit						-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	36,500	2,236,667	178,000	181,617	494,194	3,126,978
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	36,500	2,236,667	178,000	181,617	494,194	3,126,978
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	22,123	1,381,604	101,780	115,984	192,367	1,813,858
Amortizimi i vitit	2,875	171,013	15,244	16,408	53,790	259,330
Nxjerrje jashtë përdorimit						-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	24,998	1,552,617	117,024	132,392	246,157	2,073,188
Amortizimi i vitit	2,300	136,810	12,195	12,306	49,607	213,218
Nxjerrje jashtë përdorimit						-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	27,298	1,689,427	129,219	144,698	295,764	2,286,406
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	14,377	855,063	76,220	65,633	236,077	1,247,370
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	11,502	684,050	60,976	49,225	248,037	1,053,790
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	9,202	547,240	48,781	36,919	198,430	840,572

9. LLOGARI TE TJERA TE ARKETUESHME

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Pjesmarje ne kapitalin e T&C Kosova	100,000	100,000
	100,000	100,000

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve per faturat e pranuar dhe ato te pamberritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Furnitore All	1,828,911	1,767,491
Furnitore Euro	7,990,950	8,657,162
Furnitore Sek	466,012	495,664
Furnitore per fatura te pa mberitura All	13,769	20,139
	10,299,642	10,940,456

11. PARAPAGIMET E ARKETURA

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Parapagim nga klient	83,468	-
	83,468	-

12. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paga per t'u paguar	3,312,846	3,533,072
Sigurime shoqerore & shendetesore	61,188	25,547
Tatimin mbi te ardhurat personale	38,096	18,150
Tatim ne burim	216,398	216,398
TVSH per t'u paguar	-	515,623
Illir Trebicka detyrim per dividend	688,500	688,500
Genc Sokolaj detyrim per dividend	270,000	270,000
Arjana Abdi detyrim per dividend	391,500	391,500
Te tjera	704,445	3,193,660
	5,682,973	8,852,450

13. DETYRIME TE TJERA AFATGJATA

TREMA TECH SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)*

Ne kete ze eshte paraqitur detyrimi qe ka shoqeria ndaj ortakut te shoqerise. Me poshte eshte paraqitur ky detyrim per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Financim nga Ortaket	8,526,212	8,534,785
	<u>8,526,212</u>	<u>8,534,785</u>

14. KAPITALIAKSIONAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 12,000,000 Leke.

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga shitja e Gjeneratoreve dhe pjeseve	5,037,341	9,366,325
Te ardhura nga Kryerja e Sherbimit te riparimeve	1,347,845	861,804
Te ardhura te tjera	-	247,130
	<u>6,385,186</u>	<u>10,475,259</u>

Rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar ne FDP e TVSH eshte si me poshte:

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne e Tatim Fitimit	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	6,468,652
Parapagim 2014	(83,466)
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	<u>6,385,186</u>
Fitim nga kembimet valutore	73,418
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	<u>6,458,604</u>

16. LENDET E PARA DHE SHERBIMET

TREMA TECH SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lek)*

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kosto e materialeve te para	613,701	314,154
Dieta	60,000	69,427
Shpenzime per komunikim	190,961	261,784
Transport	53,215	-
Kosto e mallrave te shitur	3,981,855	6,979,940
Nenkotraktore	-	3,484
Mirembajtje dhe riparime makinerite dhe fabrika	56,680	39,082
Qera	-	466,980
Prime sigurimi	-	8,000
Energji elektrike, uje	33,479	64,788
	4,989,891	8,207,639

17. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per paga	1,654,500	6,155,000
Shpenzime per sigurime shoq e shend	161,411	694,780
	1,815,911	6,849,780

18. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane te analizuara si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime administrative dhe noteriale	8,600	3,100
Konsulenca ekonomike dhe juridike	329,487	419,475
Blerje te ndryshme,kancelari etj	833	720
Komisione bankare	70,841	81,134
Taksa te ndryshme	43,356	80,755
Gjoha te ndryshme	18,514	62,343
Te tjera	37,474	-
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	28,618	617,639
	537,723	1,265,166

19. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa	(2,149)	-
Te ardhura nga interesat	9	164
Humbje nga kembimet valutote	(22,680)	(151,950)
Te ardhura nga kembimet valutore	73,409	115,511
	48,589	(36,275)

20. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Fitimi para tatimit	(1,122,968)	(6,142,931)
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	47,132	679,982
Shpenzime pritje & percjellje		
Shpenzime udhetimi		
Penalitet, gjoba e demshperblime	18,514	62,343
Shpenzime te tjera	28,618	617,639
Fitimi Tatimor	(1,075,836)	(5,462,949)
Humbje fiskale e mbartur	(1,075,836)	(5,462,949)
Tatim fitimi 15%,10%		
Fitimi/Humbja Neto	(1,122,968)	(6,142,931)

21. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje

(Vlerat janë në Lek)

gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërise nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen perfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

22. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.